Fakti që administrata publike ballafaqohet direkt me zbatimin e shumë politikave, dhe ndikimi i saj në jetën e qytetarëve është i drejtëpërdrejtë, e bënë të pashmangshme nevojën për një kontroll permanent dhe të vazhdueshëm.

Disa nga format e kontrollit që ushtrohen ndaj administratës publike janë: kontrolli teknik, politik dhe kontrolli juridik. (Stavileci, 2010)

Në kuadër të kontrollit të administratës publike, kemi kontrollin e mbrendshëm i cili realizohet në dy forma: institucional dhe hierarkik. Kontrolli institucional realizohet me shfrytëzimin e drejtës së ankesës nga pala e pakënaqur me vendimin e administratës, ndërsa kontrolli hierarkik ushtrohet ex officio-sipas detyrës zyrtare të organit që ushtron kontrollin.

Kontrolli i jashtëm përfshinë disa modele të kontrollit, disa nga këto janë: kontrolli politik, kontrolli gjyqësor si dhe kontrolli nga ombudsmeni ose avokati i popullit. Në kuadër të kontrollit të jashtëm, një rëndësi të veçantë e ka edhe kontrolli gjyqësor, si një instancë me një rëndësi të jashtëzakonshme, e i cili në pamjaftueshmëri të kontrollit të mbrendshëm, ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe në mbrojtjen e institucionit. Në Republikën e Kosovës, forma e ushtrimit të këtij kontrolli realizohet në kuadër të gjykatës themelore të Prishtinës e cila ka në kuadër të saj, njësinë e veçantë për qështje administrative e cila shqyrton të gjitha rastet në Republikën e Kosovës. Mirëpo për shkak të shumë arsyeve të cilat do i cekim në vijim, Republika e Kosovës ka nevojë për krijimin e një institucioni të specializuar siq është ai i Gjykatës Administrative e cila do ta bënte më të lehtë edhe funksionimin e sistemit gjyqësor në

Kosovë mirëpo njëkohësisht do të kontribonte në mënyrë të drejtëpërdrejt në mbrojtjen e të drejtave dhe lirie të njeriut. Fakti që një masë e madhe e të drejtave dhe lirive të njeriut kanë raport të drejtëpërdrejtë me administratën, shton nevojën për një kontroll mbi punën e kësaj të fundit, dhe monitorim të zbatimit të njerit nga parimet me një rëndësi jashtëzakonisht të madhe siq është edhe parimi i ligjshmërisë e për të cilin do të flasim në vazhdim.

### **3. Themelimi i gjykatës administrative, dhe ndryshimet në ligjin për vetëqeverisje lokale**

#### **3.1 Ndikimi i tyre në zbatimin më efikas të parimit të ligjshmërisë, përmes së cilit synohet mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e interesit publik.**

Kontrolli i administratës nuk është vetëm evidentimi thjeshtë i parregullësive, sepse me ushtrimin e kontrollit nuk konstatohet vetëm nëse puna e organit të caktuar ka qenë e ligjshme, por edhe nëse shërbimi si organizatë administrative funksionon sipas ligjit, nëse është drejte eventdosur, dhe e organizuar si dhe nëse njerzit e duhur ushtrojnë pozitën e duhur.

Në raportet e vlerësimit të ligjshmërisë të akteve të kuvendeve të komunave të vitit 2021 konstatohet që: *Nga raporti i shkeljeve për vitin 2021, janë evidentuar 29 shkelje të cilat nuk janë rishqyrtuar fare nga ana e 9 komunave si vijon : Prishtinë 12, Deçan 4, Prizren 3, Mitrovicë Veriore 4, Suharekë 2, Vushtrri 1, Mamushë 1, Gjilan 1, Pejë 1.*

#### *Natyra e shkeljeve*

Aktet e komunave që janë kthyer në rishqyrtim dominojnë ato të cilat kanë të bëjnë me dhëniene pronës komunale në shfrytëzim, si dhe rastet e dhënies së pronës komunale me negocim të kryetarit të komunës, rastet e këmbimit të pronës komunale, shpallja me interes të pronës, bartjen e pronës komunale ndërrimin e titullarit, dhëniene e pronës komunale për bashkësitë fetare, aktet që kanë të bëjnë me transparencën komunale, si dhe aktet që kanë të bëjnë me formimin e komiteteve obligative (KPF dhe KK) për barazinë gjinore si dhe përfaqësimin e subjekteve politike të dala nga zgjedhjet lokale të mbajtura më 2021.

Sa i përket akteve të dërguara në Ministrit e Linjës, MAPL në këto ministri ka përcjellë për vlerësim 636 akte e prej të cilave nga Ministritë e Linjës 538 akte janë konfirmuar si të ligjshme ndërsa 98 janë konstatuar të kundërligjshme. Për të gjitha shkeljet e konstatuara, nga Ministrit e linjës, përmes MAPL-së, ju është dërguar komunave kërkesat për rishqyrtim. Paspranimit të kërkesave për rishqyrtim, komunat kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 60 akte, 2 prej të cilave mbesin të pezulluara për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve lokale (Prishtinë) konform kërkesës së Ministrive të Linjës, ndërsa nga 38 kërkesa që mbesin të pa harmonizuara.

Gjithashtu pa u rishqyrtuar fare janë 24 kërkesa nga ana e komunave konformë kërkesës së MAPL-së, 8 prej tyre janë dërguar në Ministri të Drejtësisë – Avokaturën Shtetërore



për t'u kundërshtuar në Gjykatë pas kalimit të afatit (Prishtinë, (3), Deçan (3), Mamushë (1) dhe Prizren (2).

Aktet e kthyer nga Ministritë e Linjës kanë të bëjnë me hartimin e planeve zhvillimore komunale, pastaj rregulloret për tarifa dhe gjoja komunale, vendime për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e objekteve të ndryshme e të cilat nuk janë harmoni me planet zhvillimore, rregullore për grumbullimin e mbeturinave, Hartat zonale të komunave, ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, vendimet për emërtimin e rrugëve, planet për menaxhimin e mbeturinave, Planit Lokal për menaxhimin e mbeturinave, emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve, shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, pëlqimin mjedisore për raportin e vlerësimit strategjik mjedisor të PZHK-së, aktetqë kanë miratuar kuvendet e komunave për dhënien e autorizimit për huamarrje (kredi) nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim(BERZH), Vendimin për fillimin e hartimit të planit të banimit për programe të veçanta të banimit, vendimet për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive, si dhe vendimet për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022 etj. (Lokal, Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave, janar- dhjetor, 2021).

Kategoria e Aktit	Numri i Aktit
Akte të miratuara nga Kuvendet e Komunave (2021)	1561
Rregullore të miratuara nga Kuvendet e Komunave (2021)	83
Vendime të miratuara nga Kuvendet e Komunave (2021)	1478
Akte të vlerësuara nga MAPL	925
Akte të dërguara në Ministritë e Linjës për vlerësim	636
Akte të konfirmuara si të ligjshme nga Ministritë e Linjës	538
Akte të konstatuara si të kundërligjshme nga Ministritë e Linjës	98
Akte të kthyer për rishqyrtim nga MAPL në komunat	61
Akte të rishqyrtuara dhe harmonizuara nga komunat	56
Akte që mbetën pa u rishqyrtuar nga komunat	5
Akte të dërguara në Ministri të Drejtësisë për kundërshtim në gjykatë	4

Në këtë tabelë janë paraqitur numri i vendimeve të cilat janë trajtuar nga MAPL si dhe numri i vendimeve të kthyer për rishqyrtim nga MAPL.

Gjithashtu edhe raporti i vitit 2022 pasqyron raste thuajse të natyrës së njejt me vitin 2021.

Numri i këtyre rasteve është i paraqitur në tabelen në vazhdim.

Lloji i vendimit	Numri i akteve/vendimeve	Shënime
Akte të dërguara për vlerësim nga Ministria e Linjës	1194 akte	Për vitin 2022
Akte të konfirmuara si të ligjshme	1084 akte	Këto janë konfirmuar si në përputhje me ligjin nga Ministria e Linjës
Akte të konstatuara si të kundërligjshme	110 akte	Akte që u konstatuan me shkelje dhe u dërguan për rishqyrtim
Akte të harmonizuara nga kuvendet e komunave	101 akte	Akte të cilat kuvendet e komunave i kanë rishikuar dhe harmonizuar
Akte që mbetën kërkesa për rishqyrtim (pa harmonizuar)	9 akte	Komuna e Fushë Kosovës (5 akte) dhe Komuna e Prishtinës (4 akte)
Akte të dërguara në Gjykatë për kundërligjshmëri	5 akte	Akte të dërguara në Gjykatë nga MAPL përmes Avokatit të Shtetit në lidhje me Komunën e Fushë Kosovës
Akte që mbetën pa harmonizuar dhe pa dërgim në gjykatë	4 akte	Këto akte i përkasin Komunës së Prishtinës

Në bazë të këtyre raporteve del se rëndësia e këtyre vendimeve është e madhe dhe mundësia eshaktimit të dëmeve, në rastin e fillimit të zbatimit të tyre, si vendime të kontestuara nga niveli qendror është e lartë, ne konstatojmë që krijimi i një institucioni të specializuar si Gjykata Administrative do të kishte këto përparësi:

- Rritja e besimit të qytetarëve mbi punën e administratës,
- Ngritja e profesionalizmit të gjyqtarëve të cilët merren me qështje administrative sepsetë njejtit do te kenë mundësin të profilizohen vetëm në qështje administrative, si dhe
- Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor.

Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik në çështjet administrative. Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor. (HAJDARI, 2019)

Konflikti administrativ mund të filloj vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurë administrative në shkallë të dytë. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimimi nuk është i lejuar. Konflikti administrativ mund të filloj edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës së palës,

nën kushtet e parashikuara me këtë ligj (Hajdari, 2019).

Krijimi i gjykatës administrative, garanton që çështjet që i përkasin një fushe specifike të juridiksionit të gjykohen vetëm nga gjyqtarë të specializuar në këtë fushë. Duke u marrë shumë më shpesh me një gamë të kufizuar çështjesh, këta gjyqtarë mund të zhvillojnë dhe akumulojnë ekspertizën për të nxjerrë vendime me cilësi të lartë, që nuk do të kenë nevojë të ndryshohen nga shkallët më të larta, nëse kundër tyre bëhet ankim. Ato mund t'i gjykojnë këto mosmarrëveshje më me efikasitet dhe shpejtësi, pasi atyre u duhet më pak kohë për të hetuar dhe reflektuar mbi elementët themelore të çështjes; ato zhvillojnë praktika specifike për menaxhimin e çështjeve dhe ata mund t'i drejtojnë dhe orientojnë palët në fazat e para të gjykimit. Autoriteti i gjyqtarëve të specializuar ka mundësi më shumë të pranohet nga palët dhe avokatët, sidomos nëse ata vetë janë të specializuar apo me eksperiencë në fushën përkatëse (Gërgji, 2011).

Kështu që duke u bazuar në këto përparësi të krijimit të Gjykatës Administrative si institucion i specializuar, ne kontribuojmë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rritjen e efikasitetit të zgjidhjeve të konflikteve administrative, ofrimin sa më të shpejt dhe më profesional të përgjigjive për ankesat e qytetarëve si palë në procedurë administrative apo edhe zgjidhjen e proceseve kontestimore në mes dy institucioneve në procedurë administrative. Kjo ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në zbatimin e parimit të ligjshmërisë, e përmes së cilit mbrohen të drejtat e qytetarit dhe interesi publik në përgjithësi. Vonesat e mëdha të shkaktuara si pasojë e një numri të madh të lëndëve në një njësi të veçantë në kuadër të gjykates themelore të Prishtinës, e përpos kësaj edhe kthimi në rigjykim i shumë lëndëve nga gjykata e apelit e për shkak të kësaj të vijëderi tek parashkrimi i lëndëve dhe humbja e arsyeshmërisë së zgjidhjes së një qështje administrative, është një faktor kyç që na shtyn drejt procesit të krijimit sa më të shpejtë të Gjykatës Administrative si një institucion i cili do të zgjidhte këto probleme.

#### **4 Aspektet krahasuese të vlerësimit të ligjshmërisë me shtetet në rajon**

##### **4.1. Republika e Shqipërisë – Aspektet Krahasuese**

Gjykatat Administrative ne Republikën e Shqipërisë dhe ndër to Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, nisën funksionimin e tyre në datë 04.11.2013 sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 8349, datë 14.10.2013. Gjykatat Administrative përbëjnë një risinë organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Më parë, gjykimi administrativ zhvillohej në seksionet administrative të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore (seksione të ngritura jo në çdo Gjykatë). Gjykimi administrativ konsiderohej si një nga gjykimet e posaçme të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (Titulli III, Kreu II, tanimë i shfuqizuar).

Funksioni kryesor i Gjykatave Administrative është dhënia e drejtësisë në mosmarrëveshjet që lindin nga zbatimi i akteve administrative individuale, akteve nënligjore normative (kjo kompetencë i takon Gjykatës Administrative të Apelit) dhe kontratave administrative, mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik, mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të

ndryshme administrative, në rastet e parashikuara në ligj, mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike si dhe gjykimet për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative që dënohen me heqje lirie deri në 30 ditë apo kërkesat për zëvendësimin e këtij dënimi. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është instaluar Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) si dhe Sistemi RDA për regjistrimin audio të seancave gjyqësore. (Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, 2013).

#### **4.2. Republika e Maqedonisë – aspektet krahasuese**

Themelimi i kësaj gjykate paraqet inovacion në kuadër të sistemit juridik të Maqedonisë, ngafakti se ajo themelohet në vitin 2007. Ajo është themeluar me ligjin për Gjykatat (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr 58/06) dhe nga data 05.12.2007 kjo gjykatë fillon me punë. Risi tjetër është formimi i Gjykses Administrative kompetente për zgjidhjen e ligjshmërisë së akteve të administratës publike me ç’rast erdhi deri tek shkarkimi apo lehtësimi i Gjykses Supreme nga lloje të tilla lëndësh. Kjo Gjykatë e ushtron pushtetin e saj në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, mirëpo selia e saj gjendet në Shkup. Ajo numëron 19 anëtarë, i cili numër mundtë rritet me vendim të Këshillit Gjyqësor, i cili njëherit zgjedh gjyqtarët dhe kryetarin e saj. Gjyqtarë në këtë gjykatë mund të zgjidhet personi që ka përvojë pune të dëshmuar në gjykatëprej së paku pesë vite ose tetë vite përvojë nga dhënia e provimit të judiktaturës poashtu edhe profesori universitar me thirrje shkencore doktor i shkencave juridike. Gjykata administrative është gjykatë e specializuar, kompetente për të vedosur në kontekste administrative për ligjshmërinë e akteve inndividuele të administratës publike dhe organeve të tjera dhe trupave të cilat kan autorizime publike dhe konteste të tjera në lidhje me zbatimin e të drejtës nga anae administrates publike. (Berisha, 2019)

Duke marrë parasysh përvojat pozitive të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, Kosova mundtë përfitojë nga disa veprime praktike:

Specializimi i Gjykatave Administrative – Shqipëria ka krijuar një sistem të dedikuar për gjykatat administrative, të cilat trajtojnë mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale dhe marrëveshjet me administratën publike. Ky model i gjykatave të specializuara ndihmon në përmirësimin e drejtësisë administrative dhe siguron që këto çështje të trajtohen nga gjyqtarë të cilët kanë përvojë dhe ekspertizë në këtë fushë.

Lehtësimi i Gjykatave – Maqedonia e Veriut ka krijuar një Gjykatë Administrative të specializuar për të zgjidhur çështjet administrative, duke e lehtësuar barrën mbi Gjykatën Supreme. Ky hap ka sjellë rritjen e efikasitetit në sistemin gjyqësor dhe ka përsheptuar proceset administrative. Kosova mund të përfitojë duke krijuar një strukturë të ngjashme, në mënyrë që çështjet administrative të mos bllokojnë gjykatat më të larta.

## 5. Përfundimi

Përmbledhja dhe analiza e historisë dhe zhvillimit të administratës publike në Kosovë ofron një perspektivë të thellë mbi evoluimin e saj gjatë tre periudhave kyçe: 1999-2000, 2000- 2008 dhe 2008-2023. Paslufta dhe vendosja e UNMIK-ut si administratë e përkohshme shënjuan një fazë të vështirë dhe transformuese për Kosovën, ku sfidat kryesore përfshin krijimin e strukturave administrative dhe harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare dhe nevojat lokale.

Në periudhën 2000-2008, pas stabilizimit të situatës pas konfliktit, Kosova nisi një proces gradual të ndërtimit dhe modernizimit të administratës publike. Këtu përfshihen iniciativat për trajnimin e personelit, adoptimin e teknologjive të reja dhe rishikimin e legjislacionit përtë përshtatur me kushtet aktuale dhe standardet ndërkombëtare.

Nga viti 2008 deri në 2023, Kosova përjetoi një periudhë konsolidimi dhe përpjekjesh për reformë në administratën publike. Zhvillimi i strategjive dhe iniciativave për të përmirësuar efikasitetin dhe për të adresuar sfidat si politizimi dhe mungesa e profesionalizmit shënoi një angazhim të vazhdueshëm për të forcuar qeverisjen dhe transparencën në administratën publike.

Gjatë këtyre periudhave, kontrolli ligjor mbi administratën publike luajti një rol të rëndësishëm në sigurimin e ligjshmërisë dhe transparencës në qeverisjen lokale. Megjithatë, sfidat mbeten të qarta dhe nevoja për një përmirësim të vazhdueshëm të mekanizmave të kontrollit dhe funksionimit të administratës publike mbetet një prioritet kryesor për të ardhmen. Në kuadër të rekomandimeve sa i përket formave të kontrollit ligjor si dhe zbatimit më efikas të parimit të ligjshmërisë janë:

**Rekomandimi për krijimin e Gjykatës Administrative.** Gjatë analizës së raporteve vjetore të publikuara nga MAPL mbi ligjshmërinë e vendimeve të kuvendeve të komunave kemi evidentuar se një numër i konsiderueshëm i akteve komunale janë rikthyer për rishqyrtim nga MAPL dhe Ministritë e Linjës, duke shkaktuar mbingarkesë administrative dhe vonesa në zbatimin e ligjit. Pjesë e këtij problemi është edhe mungesa e efikasitetit në trajtimin e këtyre rasteve nga gjykatat e përgjithshme. Krijimi i një Gjykatë Administrative të specializuar do të mundësonte trajtimin më të shpejtë dhe efikas të këtyre çështjeve, i cili do të kontribuonte në mënyrë të drejtëpërdrejtë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut sidhe mbrojtjen e interesit publik.

**Rekomandimi për ndryshimet konkrete në ligjin për vetëqeverisje lokale.** Në përputhje me gjetjet e raportit, MAPL aktualisht ka një rol të kufizuar në mbikëqyrjen dhe suspendimin e akteve të jashtëligjshme. Ndryshimi i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është i nevojshëm për të ofruar qartësi ligjore dhe për t'i dhënë MAPL-së fuqinë për të suspenduar përkohësisht aktet e jashtëligjshme derinë harmonizimin e tyre me ligjet në fuqi. Ky ndryshim do të përshpejtonte procesin e përmirësimit të ligjshmërisë dhe do të shmangte vonesat që hasen gjatë rishqyrtimit dhe harmonizimit. Kjo do të ndihmojë në garantimin që aktet e jashtëligjshme të mos jenë në fuqi për periudha të gjata dhe do të rrisë përgjegjshmërinë në qeverisjen lokale.

## Referencat

- 2022-2026, s. E. (20.05.2022). Gjetur në <https://konsultimet.rks-gov.net/viewconsult.php?consultationid=41405>
- Batalli, m. (2012). *Reforma e administratës publike në Kosovë*. Prishtinë.
- Berisha, f. H. (2019). *Administrata publike dhe kontrolli i saj*. Pejë: shoqata e shkrimtarëve të pejës. Gërgji, i. P. (2011). *Domosdoshmëria e krijimit të gjykatave administrative*. Revista shqiptare për studime ligjore.
- Gjykata administrative e shkallës së parë tiranë*. (2013). Gjetur në <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-e-shkall%c3%abs-s%c3%ab-par%c3%ab-tiran%c3%ab/gjykata-administrative-e-shkall%c3%abs-s%c3%ab-par%c3%ab-tiran%c3%ab/gjykata/rreth-gjykat%c3%abs/>
- Group, b. P. (2020). *Reforma e administratës publike në Kosovë - një përpjekje evazhdueshme*.
- Hajdari, f. B. (2019). *Administrata publike dhe kontrolli i saj*. Pejë. Hajdari, f. B. (2019). *Administrata publike dhe kontrolli i saj*. Pejë.
- Kipred. (2005). *Administrimi dhe qeverisja në Kosovë*. Prishtin/gjenevë: kipred. Ligji për vetëqeverisje lokale. (2008).
- Lokal, m. E. (2021). *Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave, janardhjetor*.
- Lokal, m. E. (2022). *Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave, janardhjetor*.
- Pips&fol. (2021). *Raport përmbledhës mbi reformën e administratës publike në Kosovë*. Prishtinë. Stavileci, e. S. (2010). *E drejta administrative*. Prishtinë: universiteti i prishtinës.
- Union, o. A. (2008). *Kosovo public service and the administrative framework assessment may 2008*.



# Sfidat e parandalimit të kriminalitetit tek të miturit në sistemin penitenciar shqiptar

Esjurda Tallushi, PhD<sup>2</sup>,

Marinela Sota, Prof. Asoc. Dr.<sup>3</sup>

## Abstrakt

Në Shqipëri, mbetet sfida pjesë e parandalimit të kriminalitetit tek të miturit e cila lidhet direkt me ndërveprimin e mekanizmave ndërinstitucionalë që kanë prioritet parandalimin e të miturve për t'u bërë pjesë e sistemit penitenciar. Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i sfidave të parandalimit të kriminalitetit tek të miturit në sistemin penitenciar shqiptar.

Metoda e përdorur e kërkimit është ajo cilësore e bazuar në intervista me të gjithë profesionistët e zinxhirit institucional të institucioneve korrektuese: 15 subjekte të përzgjedhura përmes kampionimit me qëllim.

Disa nga gjetjet e studimit lidhen me: mungesën e kapaciteteve njerëzore në instancat e pushtetit lokal të cilat nuk merren vetëm me të miturit në konflikt me ligjin, por duhet të mbulojnë edhe shumë targete të tjera të miturish. Legjislacioni për të mitur nuk është shoqëruar me të gjitha strukturat e mirëfillta të koordinimit me shërbime konkrete, Mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional, mbështetjes së familjeve me politika sociale konkrete mbetet një sfida për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit..Ndërgjegjësimi në lidhje me veprat penale tek prindërit, por edhe vetë fëmijët të fillojë në cdo shkollë të vëndit që në ciklin e lartë të arsimit 9-vjecar.

**Fjalë kyç:** parandalim, sistem penitenciar, i mitur, sfida, kriminalitet.

## Hyrje

Parandalimi i kriminalitetit tek të miturit mbetet një prioritet për sa kohë shifrat e përfshirjes direkt e indirekt të të miturve në vepra penale mbeten të larta. Legjislacioni ndërkombëtar i jep prioritet jo vetëm integritimit në shoqëri të të miturve në konflikt me ligjin përmes politikave sociale, por sidomos parandalimit të kriminalitetit tek të miturit.

Mosha 14-18 vjec mbetet një target grup vulnerabël edhe për shkak të vulnerabilitetit të familjes , shkollave por edhe moshës së fëmijëve në parandalimin e kriminalitetit tek ata.E rëndësishme është të theksohet edhe fokusi konkret apo mangësitë që mund të ketë puna

---

<sup>2</sup> Email: [esjurda3tallushi@gmail.com](mailto:esjurda3tallushi@gmail.com) Universiteti i Tiranës Shqipëri: Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Punës dhe i Politikës Sociale

<sup>3</sup>Email: [sotamarinela@yahoo.com](mailto:sotamarinela@yahoo.com) Universiteti i Tiranës,Shqipëri: Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Punës dhe i Politikës Sociale

në parandalimin e kriminalitetit në moshë të hershme tek të miturit nga këndvështrimi i profesionistëve.

Qëllimi i punimit: Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i sfidave të parandalimit të kriminalitetit tek të miturit në sistemin penitenciar shqiptar.

Në Shqipëri, përveç përjasjeve ndërkombetare në kuadrin ligjor e në praktikat në interesin më të lartë të të miturve, mbetet sfidë pjesa e parandalimit të kriminalitetit tek të miturit. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, pavarësisht anëve pozitive u shoqërua edhe me efekte negative si recidivizmi tek të miturit si pasojë e Drejtësisë Miqësore me ta, shfrytëzimit nga të rriturit të të miturve për vepra penale, mungesën e qartësisë së interpretimit të masave shoqëruese edhe të të miturve nën 14 vjeç të cilët janë nën përgjegjësinë e prindërve. Për këtë kërkohet ndërveprimi i mekanizmave ndërinstitucionalë për ngritjen e mirëfunksionimit të strukturave të reja të cilat kanë si prioritet parandalimin e të miturve për t'u bërë pjesë e sistemit penitenciar.

### Shqyrtimi i literaturës

Sipas Konventës së të Drejtave të Fëmijës, koncepti "i mitur" nënkupton personin që nuk ka mbushur ende moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Në moshën 14 vjeçare fillon përgjegjësia penale. Por mosha nga 14-18 vjeç përkon me adoleshencën. Në këtë studim termat "i mitur" dhe "adoleshent" kanë të njëjtin kuptim. Sjellja devijante në këtë studim nuk nënkupton vetëm shmangien ndaj normave, sjelljen anti-sociale, por edhe mos zbatimin e aspektit juridik, pra i referohet edhe sjelljes delinkuente.

Kërkimet bëjnë të qartë se mbyllja e fëmijëve në institucione është një proces shumë i dhimbshëm për çdo fëmijë; ajo dëmton zhvillimin e fëmijës dhe jep efektin e kundërt në socializimin e tij/saj.<sup>4</sup>Gjithashtu, në përgjithësi, është pranuar që mohimi i lirisë rrallëherë është një masë efektive për sa i përket rehabilitimit, riintegritit dhe parandalimit të shkeljeve të mëtejshme. Fëmijëve shpesh u mohohet liria për shkelje të vogla jo të dhunshme ose edhe pa kryer asnjë shkelje.<sup>5</sup>

Sipas Konventës së të Drejtave të Fëmijëve, respektimi i të drejtave si arsimimi, kujdesi shëndetësor, mbrojtja nga abuzimi dhe shfrytëzimi, informacioni i përshtatshëm, një standard i duhur jetese dhe udhëheqja e përshtatshme morale ndihmon në mbajtjen e fëmijëve larg përfshirjes në krime dhe është thelbësor kur trajtohen ata që hyjnë në konflikt me ligjin.<sup>6</sup>

Studiuesit e sjelljes penale në moshat e reja, pohojnë se adoleshentët që përfshihen në dhunime të pronës apo sjellje të dhunshme shfaqin disa nga sjelljet e mëposhtme; kanë probleme të sjelljes që në moshën parashkollore kanë sjellje problematike si tendenca për të gënjyer dhe vjedhur: kanë sjellje hiperaktive dhe impulsive që në moshat e reja ; mungesa e

---

<sup>4</sup> KSHH, (2009). Drejtimi Human i Burgjeve. Manual për drejtimin e lartë në burgje, f.16.

<sup>5</sup> Sufaj, F., Sota, M., Gjoka, R., (2012). Manual trajnimi për profesionistët që punojnë me fëmijët në sistemin penitenciar, Save the Children, f.7

<sup>6</sup> Konventa e të Drejtave të Fëmijëve, (1989), OKB.

ndjesisë së fajit, mungesa e empatisë; inteligjencë e ulët; natyrë depresive/sjellje e tërhequr; qëndrime pozitive ndaj sjelljeve problematike; frustracioni etj.<sup>7</sup>

Studimet tregojnë se adoleshentët e përfshirë në sjellje penale që shoqërohen me grupe problematike janë më të prirur të përfundojnë më shpejt në burg sesa ata që nuk janë pjesë e grupeve problematike.

## **Metodologjia**

Metoda e përdorur e kërkimit është ajo cilësore e bazuar në intervista me pyetje të hapura me të gjithë punonjësit profesionistë të zinxhirit institucional të institucioneve korrektuese si Instituti i të Miturve në Konflikt me Ligjin që kanë trajtuar të mitur në konflikt me ligjin e mund të referojnë raste të barrierave për parandalimin e krimit tek të miturit, por edhe institucioneve me fokus komunitar, instancat e pushtetit lokal si Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Qendra e Parandalimit të Krimeve, Agjensia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Komisaritetet e Policisë me përfaqësues të të Miturve si dhe përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse që kanë kontribut ndër vite me këtë fokus. Intervistat janë realizuar me 15 subjekte të përzgjedhura përmes kampionimit me qëllim nga këto institucione. Fokusi ka qenë tek profesionistët të cilët kanë 5-10 vite në profesion e në kontakt me të miturit në konflikt me ligjin duke i trajtuar e dhënë shërbimet përkatëse. Por edhe kjo ka qenë e vështirë për shkak të lëvizjeve të shpeshta të stafit rekrutues, ndaj edhe kampionimi i qëllimshëm në formë orteku ndihmoi në realizimin e intervistave. Transkriptimi i intervistave e citimet kryesore në lidhje me pyetjet e ngritura janë përdorur edhe si pjesë e analizës së të dhënave. Gjithashtu, pjesë e këtij studimi u bënë edhe të dhënat sekondare të cilat kanë patur rëndësi për të krahasuar qasjet gjatë diskutimeve, deri në gjetjet përfundimtare të këtij punimi.

## **Pyetjet kërkimore**

Studimi përmban pyetje kërkimore për të cilat jep edhe përgjigjet përkatëse gjatë gjetjeve. Konkretisht ato janë:

- 1- Cilat janë sfidat praktike në përfshirjen e profesionistëve në parandalimin e kriminalitetit tek të rinjtë?
- 2- Cilat do të ishin instrumentet për të përmirësuar nivelet ndërdisiplinare të bashkëpunimit në ndërhyrjes në nivel makro?
- 3- Cilat do të ishin perspektivat e një qasje të re e gjithëpërfshirëse për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit?

## **Kufizimet e studimit**

Disa nga kufizimet e këtij studimi janë:

Ky kampion nuk mund të jetë i konsiderueshëm mjaftueshëm për sa i përket numrit të subjekteve sa që të arrijmë në përgjithësime të sakta. Nëpërmjet pyetjeve të hapura, subjektet

---

<sup>7</sup> CRCA, (2010) Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri- Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri, Komisioni Europian, f.36.

mund të kenë dhënë mendimin e tyre i cili kurrsesi nuk mund të përgjithësojë mënyrën e këndvështrimit e eksperiencën e secilit profesionist (që mund të ketë informacione specifike). Fakti që intervistat janë realizuar më së shumti me profesionistë pjesë të Bashkisë Tiranë përsa i përket Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, Shërbimin e Provës, bën që këndvështrimi i tyre të lidhet vetëm me realitetin në këtë zonë të Shqipërisë duke mos marrë parasysh mundësinë e infrastrukturën e shërbimeve sociale në qytete të tjera për parandalimin e kriminalitetit. Këtë tendencë e kanë thyer disa profesionistët të cilët punojnë në Institutin e Re-integrimit të Miturve në konflikt me Ligjin në Kavajë dhe profesionistët e Qendrës së Parandalimit të Krimeve për të Miturit dhe të Rinjtë, të cilët kanë në fokus të tyre si institucione të vetme në Shqipëri të gjithë të miturit nga krahanina të ndryshme të Shqipërisë. Institucionet e korrektimit, organizatat e shoqërisë civile nuk janë të vetmit kontribues sidomos kur bëhet fjalë për ndërhyrje në nivel makro, por zakonisht janë vendimarrësit pjesë e institucioneve të pushtetit lokal e qëndror që kanë përgjegjësi në hartimin e politikave adekuateve e mekanizmave institucionalë për zbatimin në praktikë të këtyre instrumentave.

### **Gjetjet e studimit**

Disa nga gjetjet e studimit përsa i përket sfidave në sistemin penitenciar mbi parandalimin e kriminalitetit tek të miturit lidhen me: mungesën e kapaciteteve njerëzore në instancat e pushtetit lokal të cilat nuk merren vetëm me të miturit në konflikt me ligjin, por duhet të mbulojnë edhe shumë targete të tjera në situatë rruge, fëmijë të neglizhuar, dhunuar e abuzuar, fëmijë të pastrehë dhe me aftësi të kufizuara. Legjislacioni për të mitur nuk është shoqëruar me të gjitha strukturat e mirëfillta të koordinimit me shërbime konkrete, por ka trajtuar edhe specifika në legjislacion që nuk lidhen me praktikën ndër-institucionale.

Punonjësja e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve ndër të tjera citon: *“Shpeshherë kam hasur barrier në bashkëpunimin e drejtorive të shkollave në Njësinë Administrative ku jam, kjo sepse nuk raportohen fëmijët braktisës të shkollave. Ne e dimë që ky është hapi i parë i cili mund të bëjë që fëmijët të jenë pre e kriminalitetit... fillon nga braktisja, neglizhenca e shkollës, e prindërve, etj”* Një tjetër punonjëse e mbrotjes së fëmijëve pjesë e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në Tiranë shprehet: *“Nuk e keni idenë se sa është numri i prindërve neglizhentë, duke filluar për fëmijët nën 14 vjeç dhe nuk janë prindër që kanë vështirësi ekonomike, por nuk kanë në fokus edukimin e fëmijëve. Më ka ndodhur të kërkoj e komunikoj shpesh me prindërit për të ardhur në takimet e Grupit Teknik Ndërsektorial dhe ato nuk duken. Shpesh kam kërkuar edhe mbështetjen e perfaqësuesve të komisariatit...”*. Sa më sipër vihet re se ka një papërgjegjshmëri institucionale në zbatimin e përcimin e informacionit në mbështetje të interesit më të lartë të fëmijës e cila krijon raste precedente për abuzim me detyrën dhe rreth vicioz për të miturit për tu përfshirë në sjellje e veprimtari kriminale. E pyetur për këtë se cilat janë politikat apo kuadri ligjor që mund ta detyrojë prindin të marrë përgjegjësi ajo shprehet: *“Nuk kemi asnjë mundësi. Edhe për gjobitje të prindit pasi të ardhurat e tyre janë të fshehura dhe nuk janë të deklaruara, përveçse nuk ka pasur raste të tilla. Nuk bëhet fjalë për heqje kujdestarie të fëmijës sepse edhe institucione ptitëse nuk ka”*- Nga kjo bisedë del shumë e qartë se cila është korniza ligjore në mbështetje të fëmijëve për ti ruajtur nga kriminalitetit: ajo ose mungon ose është konfuze apo nuk ofron mjetet kryesore për implementimin e saj

nëpërmjet strukturave të tjera mbështetëse. Punonjësja e sektorit të çështjeve sociale në Institutin e Re-integrimit të të Miturve në konflikt me ligjin shprehet: *“Parandalimi është një fazë që vihet re se mungon tek të miturit në konflikt me ligjin. Kjo do të thotë se këta të mitur përfundojnë në një institucion penitenciar si ky në momentin që nuk kanë pasur ata nga familja ose familja mbështetjen e duhur nga instancat...”* Kjo frazë shpreh qartë se si të miturit në konflikt me ligjin bëhen pjesë e statusit si i dënuar e i nënhtrohen rehabilitimit kur familja nuk ka qenë vigjilente ose i ka munguar mbështetja e politikave sociale gjatë prindërimit.

Punonjësja e Qendrës së Parandalimit të Krimeve përgjigjet: *“Sot shumë të mitur në rrethe, përveç Tiranës nuk kanë mundësi të arsimohen e të kualifikohen në kurse profesionale, mbështetje strukturash apo OJF-sh si në Tiranë...”*. Kjo deklaratë në fakt sjell në kujtesë një fakt të rëndësishëm që lidhet me zbehjen e mundësisë për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit që lidhet me mungesën e shërbimeve sociale në rrethe apo mundësitë e strukturave për të ofruar ndërhyrje konkrete për minimizimin e sjelljeve antisociale tek të miturit ende pa qenë në konflikt me ligjin. Mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional, mungesa e mbështetjes së familjeve me politika sociale konkrete në mbështetje të tyre për të shmangur neglizhimin e fëmijëve, përfshirjen e tyre në kriminalitet mbetet një sfidë me qëllim që ndihmat sociale të mos mbeten vetëm në letër si pjesë e makropolitikave.

### **Përfundime e rekomandime**

Të miturit që përfshihen në sjellje devijante kanë një rrezikshmëri shumë më të lartë për të qenë të rritur në konflikt me ligjin, ndaj edhe parandalimi i këtyre sjelljeve është mjaft i rëndësishëm. Mungesa e politikave konkrete për të shmangur lëvizjet nga detyra të stafëve të mirëtrajnuara ndër vite nuk sjell rediment tek parandalimi E rëndësishme do të ishte që ndërgjegjëdimi në lidhje me veprat penale tek prindërit, por edhe vetë fëmijët të fillojë në cdo shkollë të vëndit që në ciklin e lartë të arsimit 9-vjecar<sup>8</sup>. Ndërgjegjësimi i komunitetit apo specialistëve të fushave të tjera mbi rëndësinë e investimit në parandalimin e fenomenit. Evidentohet një mungesë informacioni specifik për të kuptuar punën një standard të kuptuari për të funksionuar si ekip multidisiplinar. Konsiderimi i mendimit të ekspertëve në planet e veprimit në mbështetje të strategjive ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin.

Përfshirja e fëmijëve në veprimtari të ligjshme, pjesëmarrja në aktivitete rekreative, kalimi efektiv i kohës së lirë do të zbuste pasojat e përfshirjes së fëmijëve në sjellje antisociale e kjo do të ndihmonte në parandalimin e kriminalitetit në shoqëri. Janë shumë të rëndësishme edhe praktikatat e disiplinimit pozitiv sipas profesionistëve e ekspertëve të intervistuar, pasi vihet re se qëndrimi indiferent i prindërve në sjelljet e papërgjegjshme të grupmoshës 14-18 vjeç rrit mundësinë për përfshirjen e tyre në vepra penale. Trinomi i bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet kërkohet të ketë një bashkëpunim të vazhdueshëm e mbi të gjitha të zbatojnë programe të cilat ndërhyrjnë në parandalimin e kriminalitetit përmes motivimit e përforsimit të sjelljeve pozitive e minimizimit të atyre asociale.

---

<sup>8</sup> Musai, Bardhyl., (2014). Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: Toena, f.93

Bashkëpunim të ngushtë ndërdisiplinor ndërmjet qeverisjeve kombëtare, shtetërore, rajonale, vendore me përfshirjen e përfaqësimit qytetar të sektorit privat për ti shërbyer bashkësisë dhe agjencive të punës, përkujdesjes për fëmijët, edukimit shëndetsor, shoqëror dhe agjencive të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit duke ndërmarrë veprime konkrete për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit dhe të rinjtë.

Shoqëria nuk ka një informacion mbi kriminalitetin tek të miturit gjë që është e domosdoshme për të parashikuar dhe ngritur shërbime në mbështetje të kriminalitetit të hershëm për të parandaluar përfshirjen e tyre në vepra penale. Brenda ose jashtë kornizave kurrikulare, Ministria e Arsimit duhet të parashikojë kurse informimi dhe trajnimi për përvetësimin e modeleve miqësore dhe demokratike të komunikimit qytetar. Kjo do të kërkojë edhe trajnimin e mësueve për të transmetuar qëndrime dhe vlera të reja në marrëdhëniet me nxënësit.

## **Bibliografia**

Sufaj, F., Sota, M., Gjoka, R., (2012). Manual trajnimi për profesionistët që punojnë me fëmijët në sistemin penitenciar, Save the Children.

Musai, Bardhyl., (2014). Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: Toena.

KSHH, (2009). Drejtimi Human i Burgjeve. Manual për drejtimin e lartë në burgje.

CRCA, (2010) Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri- Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri, Komisioni Europian.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. (1989) Konventa së të Drejtave të Fëmijëve.



# Qeverisja dhe lehtësira e të bërit biznes, si një nga sfidat në rajonin tonë

**Ph.D.c. Mirsad Sadriu**

Universiteti i Prishtinës, Prishtinë

Email: mirsadsadriu@hotmail.com

**Dr.Sc. Basri Sadriu**

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: b\_sadriu@hotmail.com

## Abstrakt

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të analizojë nëse qeverisja dhe lehtësira e të bërit biznes paraqesin sfidë të veçantë për rajonin tonë. Për këtë qëllim, në këtë hulumtim, qeverisja si nocion është e përfaqësuar nga indikatorët e qeverisjes, ndërsa lehtësira e të bërit biznes përfaqësohet nga indikatorët e të bërit biznes, të cilat burimin e kanë në databazën e Bankës Botërore. Të dhënat e përdorura në këtë studim janë të dhëna sekondare kuantitative, të analizuar përmes metodave kuantitative, duke aplikuar qasje deduktive, ku fillohet me ngritjen e pyetjeve hulumtuese, dhe pastaj përmes të dhënave të mbledhura janë nxjerrë konkluzionet përfundimtare, me theks të veçantë tek analiza krahasuese përmes grafeve. Rezultatet kanë treguar, së për të dy grupet e indikatorëve, vendet e rajonit stagnojnë krahasuar me vendet e tjera Evropiane, kështu duke demonstruar një ambient më pak të sigurtë në aspektin ekonomik.

Fjalë kyç: *qeverisje, biznes, ekonomike, lehtësira.*

## Hyrje

Edhe pse deri para disa vitesh pjesa e qeverisjes dhe mjedisi i të bërit biznes mund të shiheshin vetëm si produkt i politikave të brendshme dhe regulatorëve qeveritar, në vitet e fundit kjo ndryshoi, dhe fatëkeqësisht, për të keq. Dëshmia më e saktë e fjalisë pararendëse sot është situata në Ukrainë, ku ndërhyrja Ruse e cila filloi në vitin 2011 me invazionin në Krime, e pastaj në Shkurt të vitit 2022, në tërë kufirin me Ukrainën, tregon se sot përkeqësimi i mjedisit të të bërit biznes dhe qeverisjes mund të vijë edhe nga faktorë të jashtëm, përveq rregullimit të brendshëm. Pikërisht, në këtë studim dy koncepte bazë do të paraqiten dhe analizohen, të bërit biznes dhe qeverisja, e cila ende paraqitet si sfidë në rajonin tonë, e thënë për hirë të vërtetës burimin e ka nga brenda dhe jo nga faktorë të jashtëm, të cilët edhe pse jo me impakt sa në vatrat e luftërave, mund të shfaqen si ndikues në këtë sfidë aktuale. Për këtë të fundit, shumica e studiuesve dhe politikëbërësve e pranojnë se qeverisja e mirë është një përbërës themelor i zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, andaj shumica e përkufizimeve lidhur me qeverisjen theksojnë në mënyrë të veçantë rëndësinë e një shteti të aftë që është përgjegjës ndaj qytetarëve dhe që vepron nën sundimin e ligjit (Kaufmann and

Kraay 2007). Më poshtë janë paraqitur indikatorët e qeverisjes sipas databazës së Bankës Botërore (WorldBank):

<b>Indikator</b>	<b>Çfarë matë indikator</b>
Kontrolli i korrupsionit	Përceptimet e masës në të cilën pushteti publik përdoret për përfitime private, duke përfshirë edhe ato të vogla dhe të mëdha format e korrupsionit, si dhe "kapja" e shtetit nga elitat dhe interesat private.
Efektiviteti i qeverisjes	Perceptimet për cilësinë e shërbimeve publike, cilësinë e shërbimit civil dhe shkallën e pavarësisë së saj nga presionet politike, cilësinë e formulimit dhe zbatimit të politikave, dhe besueshmërinë e angazhimit të qeverisë për politika të tilla.
Stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës/terrorizmit	Përceptimet për mundësinë e paqëndrueshmërisë politike dhe/ose dhunës së motivuar politikisht, duke përfshirë terrorizmin.
Kualiteti i rregullatorit	Përceptimet e aftësisë së qeverisë për të formuluar dhe zbatuar politika dhe rregullore të shëndosha që lejojnë dhe nxisin zhvillimin e sektorit privat.
Sundimi i ligjit	Perceptimet e masës në të cilën agjentët kanë besim dhe respektojnë rregullat e shoqërisë, dhe në veçanti cilësia e zbatimit të kontratës, të drejtat pronësore, policia dhe gjykatat, si dhe gjasat për krim dhe dhunë.
Zëri dhe llogaridhënja	Përceptimet e masës në të cilën qytetarët e një vendi janë në gjendje të marrin pjesë në zgjedhjen e tyre të qeverisë, si dhe lirinë e shprehjes, lirinë e organizimit dhe të një media të lirë

Tabela 1: Tabela përbledhëse e indikatorëve të qeverisjes dhe asaj se çfarë matin.

Lidhur me nocionin e dytë që trajtohet në këtë hulumtim, e që është të bërit biznes, shtatë indikatorë janë përdorur më qëllim të nxjerrës së konkluzioneve duke u bazuar në pyetjet hulumtuese të ngritura, këtu duke përfshirë fillimin e një biznesi, trajtimin e lejeve të ndërtimit, marrjen e elektricitetit, regjistrimin e pronës, pagesën e taksave, zbatimin e kontratave, dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese:

<b>Indikator</b>	<b>Çfarë matë indikator</b>
Fillimi i një biznesi	Procedurat, koha, kostoja dhe kapitali minimal i paguar për të filluar një kompani me përgjegjësi të kufizuar.
Trajtimi i lejeve të ndërtimit	Procedurat, koha dhe kostoja për të përfunduar të gjitha formalitetet për të ndërtuar një magazinë dhe mekanizmat e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë në sistemin e lejimit të ndërtimit.

Marrja e elektricitetit	Procedurat, koha dhe kostoja për t'u lidhur me rrjetin elektrik, besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike, dhe transparencën e tarifave.
Regjistrimi i pronës	Procedurat, koha dhe kostoja për të transferuar një pronë dhe cilësia e sistemit të administrimit të tokës.
Pagesa e taksave	Pagesat, koha dhe norma totale e taksave dhe kontributeve për një firmë që të përputhet me të gjitha rregullat e taksave si dhe proceset pas përmbushjes.
Zbatimi i kontratave	Koha dhe kostoja për të zgjidhur një mosmarrëveshje tregtare dhe cilësinë e proceseve gjyqësore.
Zgjidhja e paaftësisë paguese	Koha, kostoja, përfundimi dhe norma e rimëkëmbjes për një paaftësi paguese tregtare dhe forca e kuadrit ligjor për falimentim.

Tabela 2: Tabela përbledhëse e indikatorëve të të bërit biznes dhe asaj se çfarë matin.

Në tabelën e mësipërme janë të paraqitur indikatorët e të Bërit Biznes së bashku me komentin për secilin indikator lidhur me pyetjen se çka matë ai indikatorë. (Group 2020).

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të analizojë ndikimin që treguesit e qeverisjes dhe të bërit biznes kanë në Produktin Bruto të Brendshëm për kokë banori për vendet e rajonit tonë. Andaj, trembëdhjetë shtete janë zgjedhur si rast studimi në këtë hulumtim, ku këto shtete janë: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, si dhe Turqia. Mbështetur në nocionet e përdorura si ndikues në PBB për kokë banori, në këtë hulumtim, indikatorët që do të përdoren për të analizuar këtë ndikim janë: Kontrolli i korrupsionit, Efektiviteti i qeverisë, Stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës/terrorizmit, Kualiteti i rregullatorit, Sundimi i ligjit, Zëri dhe llogaridhënja, Fillimi i një biznesi, Trajtimi i lejeve të ndërtimit, Marrja e elektricitetit, Regjistrimi i pronës, Pagesa e taksave, Zbatimi i kontratave si dhe Zgjidhja e paaftësisë paguese.

Ky hulumtim ka qëllim që ti përgjigjet pyetje hulumtuese si më poshtë:

PH1: Cila është pozita e vendeve të rajonit tonë krahasuar me vendet e tjera Europiane sa i përket qeverisjes dhe të bërit biznes.

PH2: Çfarë impakti kanë indikatorët e të bërit biznes në Produktin Bruto të Brendshëm për kokë banori, në vendet e rajonit që janë pjesë e studimit.

PH3: Çfarë impakti kanë indikatorët e qeverisjes në Produktin Bruto të Brendshëm për kokë banori, në vendet e rajonit që janë pjesë e studimit.

Struktura e këtij studimi, përveq hyrjes, përfshin paragrafin 2, ku shqyrtohet literatura përkatëse, e ndjekur nga paragrafi 3, ku është paraqitur analiza krahasuese e vendeve që janë pjesë e studimit me shtetet e tjera Europiane, pastaj paragrafi 4, ku analizohet metodologjia dhe të dhënat që janë përdorur për të kryer hulumtimin në fjalë, këtu duke përfshirë edhe tabelën e variablave, pastaj e ndjekur nga paragrafi 5 ku përshkruhen dhe

analizohen rezultatet e nxjerra, si dhe ne dy paragrafët e fundit, ku janë paraqitur diskutimet dhe konkluzionet e nxjerra nga analizat e bëra.

### **Rishikimi i literaturës**

Ka një numër të madh të autorëve që hulumtimet e tyre i kanë zhvilluar lidhur me impaktin që indikatorët e qeverisjes dhe të të bërit biznes kanë në aspektin ekonomik, e me theks të veçantë tek rritja ekonomike së bashku me treguesit që lidhen me të (PBB, rritja e PBB, PBB/frymë, etj.).

Autorët (Avdulaj, Merko and Muço 2021) dhe (Niarachma, Effendi and Ervani 2021) duke aplikuar regresionin e efektit të fiksuar (Fixed Effect) me qëllim të hulumtimit të impaktit të qeverisjes në investimet e huaja direkte, duke konkluduar se qeverisja efikase trego ndikim pozitiv në vlerën e investimeve të huaja, ndërsa rritja e korrupsionit reduktoi fluksin e FDI-ve, e një reduktim i saj gjeneron rritje të BPP-së për frymë. Për (Absadykov 2020), rezultatet tregojnë se kontrolli i korrupsionit ka ndikimin më të fortë në PBB për kokë banori. Gjithashtu, në hulumtimet e tyre, autorët (Nikzad and Obrenovic 2021), (Al-Naser and Hamdan 2021) dhe (Poniatowicz, Dziemianowicz and Kargol-Wasiluk 2020) konstatuan se qeverisja ka një ndikim pozitiv statistikisht në rritjen ekonomike, ku tek hulumtimi dytë, përmirësimet në qeverisje bëhen më efektive në rritjen ekonomike përdërisa vendet kalojnë nëpër faza të ndryshme të zhvillimit ekonomik, ndërsa tek hulumtimi fundit, për 28 shtetet e Bashkimit Europian, mbështetur në analizën e korrelacionit, ku nga gjashtë indikatorët e qeverisjes, vetëm stabiliteti politik si indikatorë nuk tregoi korelacion në nivelin e PBB-së për frymë. Rezultate të ngjashme konkludoi edhe (Marino, et al. 2016) për shtetet e BRICS për periudhën 2005-2012, ku nga të gjithë indikatorët e qeverisjes, edhe këtu vetëm stabiliteti ekonomik dhe indikatorit i përgjegjshmërisë kanë treguar impakt negativ në rritjen ekonomike.

Një numër i konsiderueshëm i autorëve kanë hulumtuar mbi impaktin e indikatorëve të qeverisjes në investimet e huaja direkte, sikurse në rastin e (Bouchoucha 2022) dhe (Khan, Khan and Bibi 2023), të cilët duke përdorur modelin GMM, tek hulumtimi i parë, në bazë të gjetjeve është konstatuar se indikatorët e përgjithshëm të qeverisjes tërheqin hyrjet e investimeve të huaja direkte në Afrikë dhe nën-rajonet e saj, ndërsa tek i dyti, për vendet aziatike, të gjithë indikatorët përveq indikatorit të kualitetit të rrgullatorit, kanë ndikim negativ ose nuk kanë ndikim fare në nivelin e investimeve të huaja direkte.

Kontrolli i korrupsionit paraqitet si një nga indikatorët me ndikimin më të lartë në tërheqjen e investimeve të huaja direkte, ku tek shumë hulumtime ku disa ose shumica e indikatorëve kanë impakt signifikant tek investimet e huaja direkte, vërehet që kontrolli i korrupsionit është i përfshirë. Këto hulumtime janë (Ponce, Navarro and Grajeda 2019) ku studimi përfshin shtetin e Kinës, (Gupta, Yadav and Jain 2023) ku si rast studimi janë përdorur shtetet e BRICS për periudhën 1996–2019 duke shfrytëzuar metodën e shpërndarsjes autoregressive, si dhe tek (Gani 2007) ku si subjekt studimi janë disa shtete të Azisë dhe Amerikës Latine.

Në anën tjetër, një sërë autorësh në hulumtimet e tyre kanë përfshirë indikatorët e të bërit biznes duke analizuar impaktin e tyre në rritjen ekonomike apo edhe tek investimet e


huaja direkte. Autorët (Febrina and Sebayang 2021) dhe (Nawawi, et al. 2021) kanë përdorur regresionin linear të shumëfishtë për të analizuar impaktin e indikatorëve të të bërit biznes në rritjen ekonomike, ku për të parën, në bazë të konkluzioneve, për shtetet e ASEAN, katër indikatorë të të bërit biznes treguan impakti signifikant në rritjen ekonomike, e ndërsa për Bashkimin Europian ky numër ishte pesë, kurse në hulumtimin e dytë, autorët konkluduan impakti pozitiv signifikant të indikatorëve të të bërit biznes në rritjen ekonomike. Rezultate të ndryshme për grupe të ndryshme të shteteve lidhur me impaktin e të bërit biznes paraqiten edhe nga (Adepoju 2017), ku autori për një hulumtim më të detajuar ka bërë ndarjen e 155 shteteve që ishin pjesë e studimit në katër kategori, mbi bazën e të hyrave, duke konkluduar që ky impakt është i ndryshëm për grupe të ndryshme të shteteve, por jo signifikant për të gjitha shtetet si mostër totale. Hulumtim për ndikimin e indikatorëve të të bërit biznes duke përdorur regresionin linear për shtete duke i ndarë në bazë të zhvillimit të tyre, përpiloi edhe (Femina, et al. 2022), ku konkludimi ishte se tek vendet në zhvillim e sipër impakti i këtyre faktorëve ishte më i madh në rritjen e investimeve të huaja direkte dhe në zhvillimin ekonomik, se sa në vendet e zhvilluara dhe ato në tranzicion. Rezultate të ndryshme mbi indikatorët e të bërit biznes veç e veç janë nxjerrë tek studimi i autores (Ani 2015), ku për 29 ekonomi të Azisë Lindore, studimi zbuloi se indikatorët e lejes së ndërtimit dhe marrja e kredisë kanë efekt negativ në Prodhimin e Brendshëm Bruto, kurse në anën tjetër, indikatorët e regjistrimit të pronës dhe tregtia përtej kufijve kanë treguar efekt pozitiv.

Po ashtu një numër i madh autorëve në hulumtimet e tyre kanë analizuar impaktin e indikatorëve të të bërit biznes në investimet e huaja direkte. Në hulumtimin e tyre, autorët (Haliti, et al. 2019) aplikuan metodologjinë dinamike të panelit, këtu duke përfshirë metodat POLS, FE, dhe GMM për gjashtëmbëdhjetë shtete Europiane në tranzicion, për periudhën 2009-2016. Mbështetur në konkluzionet e nxjerra, indikatorët të filluarit të biznesit, regjistrimi i pronës, marrja e energjisë elektrike dhe zgjidhja e insolvensës treguan impakti signifikant në tërheqjen e investimeve të huaja direkte, ndërsa variablat si marrja e lejes së ndërtimit, marrja e kredisë, pagesa e taksave dhe mbrojtja e investitorëve minoritarë kanë treguar një ndikim negativ në tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Impakte të ndryshme nga indikatorët e të bërit biznes në tërheqjen e investimeve të huaja direkte duke aplikuar modelin e katrorëve të vegjël, arritën edhe autorët (Hossain, et al. 2018), ku në bazë të të dhënave nga 177 shtete, rezultatet treguan se indikatorët zbatimi i kontratave kishte ndikim pozitiv në IHD-të, kurse në anën tjetër indikatorët si marrja e kredisë dhe regjistrimi i pronës rezultuan me ndikim negativ të investimeve të huaja direkte. Ndërsa në aspektin e ndikimit të të bërit biznes në investimet e huaja direkte, si koeficient i tërësishëm, autorët (Opuala-Charles and Oshilike 2023) dhe (Aleksnaek, et al. 2023) konkluduan se indikatorët i të bërit biznes ka ndikim në investimet e huaja direkte, ku sipas të fundit, me rritjen prej një njësi në treguesin e lehtësisë së të bërit biznes, kjo do të ndikojnë që të rritë potencialisht interesin për investime me rreth 74.6%.

### **Qeverisja dhe të bërit biznes në vendet e rajonit krahasuar me vendet tjera Europiane**

Në këtë pjesë, fokusi është tek paraqitja grafike e indikatorit të të bërit biznes dhe indikatorëve të qeverisjes për vendet Europiane, në mënyrë që të ketë një krahasueshmëri,

mbi të cilën do të vlerësohet se në qfarë pozite gjendet vendet e rajonit krahasuar me vendet tjera Europiane. Në grafikun e parë është bërë paraqitja e agreguar e nivelit të indikatorit të të bërit biznes:




Grafiku 1: Renditja e shteteve Eurpiane sipas nivelit të indikatorit të të bërit biznes - 2020

Sipas grafikut 1, ku janë paraqitur të dhënat për indikatorin e agreguar të të bërit biznes për shtetet Europiane, dhe me ngjyrë të kuqe janë paraqitur shtetet e rajonit që janë pjesë e studimit, mund të vërejmë se nga trembëdhjetë shtetet e rajonit që janë pjesë e studimit, pjesa më e madhe e tyre, më saktësisht dhjetë shtete gjenden nën mesataren ose në anën e majtë të grafikut, duke nënkuptuar rezultat më të keq, kështu duke konfirmuar se tek këto vende niveli i lehtësisë për të bërë biznes është më i ultë se sa vendet tjera europiane, kështu duke u reflektuar edhe si problem i këtij rajoni.

Më poshtë janë paraqitur grafikët specifik për të gjashtë indikatorët përbërës të qeverisjes për vendet Europiane, për arsye se nuk ka një indikatorë të agreguar të qeverisjes ku i përfshinë të gjithë indikatorët e qeverisjes, ashtu sikurse tek grafiku 1.


Në grafikun 2 është bërë paraqitja e indikatorit të kontrollit të korrupsionit për vendet Europiane:






Grafiku 2: Renditja e shteteve Eurpiane sipas indikatorit të kontrollit të korrupsionit - 2022

Bazuar në grafikun 2, vendet që janë pjesë e studimit përbëjnë pjesë në grupin me rezultate negative, ku shtetet tjera që bëjnë pjesë në këtë grup janë edhe Russia e Ukraina, që për momentin po ballafaqohen me luftë. Kjo në përgjithësi nënkupton se korrupsioni paraqet një problem të madh tek keto vende.




Grafiku 3: Renditja e shteteve Eurpiane sipas indikatorit të qeverisjes efektive – 2022

Po ashtu, edhe në grafikun 3 sikurse edhe tek grafikun 2, që paraqet renditjen e shteteve Europiane sipas nivelit të indikatorit të qeverisjes efektive, shtetet e rajonit që janë pjesë e këtij studimit gjenden në anën e majtë të grafikut, duke reflektuar kështu një nivel të ulët të qeverisjes efektive, në një grup me shtete si Bjellorusia, Ukraina, Rusia, etj., të cilat që të gjitha janë duke u ballafaquar më konflikte ndër shtetërore.




Grafiku 4: Renditja e shteteve Europiane sipas indikatorit të stabilitetit politik - 2022

Edhe tek niveli i stabilitetit politik në vendet Europiane, vërehet një pozitë e dobët e vendeve të rajonit, por këtu vlenë të ceket performanca më e mirë e dy vendeve që janë pjesë e studimit, Kroacisë dhe Sllovenisë, të cilat njëherazi janë edhe vende anëtare të Bashkimit Europian.




Grafiku 5: Renditja e shteteve Europiane sipas indikatorit të kualitetit të regullatorit - 2022



Grafiku 6: Renditja e shteteve Evropiane sipas indikatorit të sundimit të ligjit – 2022

Po ashtu, grafiku 5 dhe 6 që reflektojnë nivelin e kualitetit të rregullatorit dhe sundimit të ligjit tregojnë një pozitë të njëjtë të pothuajse tek të gjithë shtetet e rajonit.



Grafiku 7: Renditja e shteteve Evropiane sipas indikatorit të llogaridhënies – 2022

Duke përfshirë edhe grafikun 7, mund të konkludojmë së në të gjitha matjet e indikatorëve të qeverisjes nga ana e Bankës Botërore, del që vendet e rajonit, më saktësisht shumica e tyre gjenden në grupin e vendeve me rezultatin më të ulët, kështu duke treguar se qeverisja tek këto vende paraqet një sfidë, e cila gjithsesi duhet të tejkalohet duke punuar më shumë në të, me qëllim që të arrihen nivelet positive të qeverisjes sikurse tek vendet e tjera Evropiane, ku po ashtu që shumica janë pjesë e Bashkimit European.

## Metedologjia dhe të dhënat

Në këtë studim, qasja e përdorur është deduktive, e cila është aplikuar është duke përdorur të dhëna vjetore kuantitative dhe sekondare, për trembëdhjetë vende të regjionit, për periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2020<sup>9</sup>, kështu duke synuar të shpjegojë lidhjen që variablat e pavarur të përdorura në këtë punim kanë me mjedisin ekonomik në Kosovë, i shprehur në këtë hulumtim përmes Produktit Bruto të Brendshëm për kokë banori. Të dhënat e përdorura në këtë studim janë marrë nga Banka Botërore (Metadata), më konkretisht nga databaza e të dhënave të indikatorëve të zhvillimit të botës dhe databazës të indikatorëve të të Bërit Biznes. Për të analizuar impaktin e variablave të pavarura në PBB për kokë banori, autorët kanë përdorur modelin e regression linear me efekt të fiksuar (Fixed Effect), mbështetur në atë se të dhënat e përdorura janë të dhëna panel. Në tabelën 3, është paraqitur tabela përmbledhëse me listën e variablave të pavarura dhe asaj të varur, ID-në apo shkurtësën e cila do të përdoret më poshtë, llojin si dhe burimin e tyre.

Variabla	ID	Lloji	Burimi
PBB për kokë banori	PBB	Variabël e varur	Banka Botërore (Metadata)
Stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës/terrorizmit	SPMT	Variabël e pavarur	
Sundimi i ligjit	SL	Variabël e pavarur	
Efektiviteti i qeverisjes	EQ	Variabël e pavarur	
Zëri dhe llogaridhënja	ZLL	Variabël e pavarur	
Kualiteti i rregullatorit	KR	Variabël e pavarur	
Kontrolli i korrupsionit	KK	Variabël e pavarur	
Fillimi i një biznesi	FB	Variabël e pavarur	
Regjistrimi i pronës	RP	Variabël e pavarur	
Marrja e elektricitetit	ME	Variabël e pavarur	
Trajtimi i lejeve të ndërtimit	TLN	Variabël e pavarur	
Pagesa e taksave	PT	Variabël e pavarur	
Zgjidhja e paaftësisë pagueuse	ZPP	Variabël e pavarur	
Zbatimi i kontratave	ZK	Variabël e pavarur	

Tabela 3: Tabela përmbledhëse e variablave, ID-ve, llojit, si dhe burimit të tyre

Bazuar në variablat e përdorura në këtë studim, ekuacioni i regresionit që do të përdoret në studimin tonë është:

$$PBB_{it-1} = \beta_0 + \beta_1 SPMT_{it} + \beta_2 SL_{it} + \beta_3 EQ_{it} + \beta_4 ZLL_{it} + \beta_5 KR_{it} + \beta_6 KK_{it} + \beta_7 FB_{it} + \beta_8 RP_{it} + \beta_9 ME_{it} + \beta_{10} TLN_{it} + \beta_{11} PT_{it} + \beta_{12} ZPP_{it} + \beta_{13} ZK_{it} + \mu_{it}$$

<sup>9</sup> Edhe pse të dhënat për indikatorët e qeverisjes në databazën e World Bank janë të paraqitura deri në vitin 2022, duke marrë parasysh që të dhënat për indikatorët e të bërit biznes janë të paraqitura vetëm deri në vitin 2020, atëherë të dhënat e përdorura në regresion janë të periudhës 2010-2020.

Ku,  $\mu_{it}$  përfaqëson gabimin gjatë periudhës së caktuar, si dhe  $PBB_{it-1}$  përfaqëson lag të parë të Produktit Bruto të Brendshëm (PBB) për kokë banori.

### Rezultatet dhe gjetjet

Autorët në këtë studim kanë përdorur modelin e efektit të fiksuar (Fixed Effects) për të kryer analizën e regresionit të shumëfishtë, duke përfshirë variablat e përmendur në kapitullin e mëparshëm. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur analiza përshkruese më të dhënat që përfshijnë: Mesataren, Medianën, Devijimin standard, Minimumin, Maksimumin, dhe Observimet e munguara, të cilat janë zero për secilëm variabël.

Variabla	Mes.	Med.	Dev.Std.	Min.	Max.	Obs. M.
PBB për kokë banori	10725.00	8381.90	6433.90	2981.20	26717.00	0
Stabiliteti Politik dhe Mungesa e Dhunës/Terrorizmit	49.07	49.53	20.28	4.76	89.10	0
Sundimi i Ligjit	54.32	53.85	12.26	32.23	84.29	0
Efektiviteti i Qeverisjes	56.86	55.98	13.62	26.07	83.81	0
Zëri dhe llogaridhënj a	56.65	56.34	13.52	24.16	81.99	0
Kualiteti i Rregullatorit	63.17	63.94	9.53	38.10	80.86	0
Kontrolli i Korrupsionit	50.78	50.72	12.06	24.17	80.86	0
Fillimi i një biznesi	84.17	86.63	9.95	50.36	96.00	0
Regjistrimi i pronës	82.68	86.12	13.65	0.00	98.33	0
Marrja e elektricitetit	63.27	69.13	23.25	0.00	93.04	0
Trajtimi i lejeve të ndërtimit	45.67	47.84	25.90	0.00	81.27	0
Pagesa e taksave	68.07	72.64	15.81	15.15	89.18	0
Zgjidhja e paaftësisë pague	57.97	59.78	13.50	18.31	84.40	0
Zbatimi i kontratave	55.35	61.07	21.37	0.00	82.79	0

Tabela 4: Statistikat përshkruese për variablat që janë pjesë e hulumtimit.

Bazuar në tabelën e mësipërme, duke marrë parasysh se variablat e pavarura që përfshijnë indikatorët e qeverisjes dhe të të bërit biznes janë të kalkuluara sipas nivelit të pikëve nga 0 deri në 100, atëherë edhe shpërndarja është e ndikuar dhe kufizuar nga ato

vlera, e ndërsa tek variabla e varur, PBB për kokë banori, duke marrë parasysh që vlera është marrë në dollarë dhe pa u transformuar në Log ose Ln, të dhënat e mësipërme tregojnë një shpërndarje më të madhe të vlerave përshkruese, këtu duke përfshirë devijimin standard, vlerën minimale si dhe atë maksimale.

Variabla	Coefficient	Std. Error	t-ratio	p-value	
PBB për kokë banori	10,746.200	2,634.840	-4.079	<0.0001	***
Stabiliteti Politik dhe Mungesa e Dhunës/Terrorizmit	-49.563	14.475	-3.424	0.0009	***
Sundimi i Ligjit	241.129	32.073	7.518	<0.0001	***
Efektiviteti i Qeverisjes	129.291	24.176	5.348	<0.0001	***
Zëri dhe llogaridhënja	102.441	30.904	3.315	0.0012	***
Kualiteti i Rregullatorit	56.811	28.801	1.972	0.0509	*
Kontrolli i Korrupsionit	-30.454	30.299	-1.005	0.3169	
Fillimi i një biznesi	-51.248	18.202	-2.816	0.0057	***
Regjistrimi i pronës	32.406	13.599	2.383	0.0188	**
Marrja e elektricitetit	39.105	8.765	4.462	<0.0001	***
Trajtimi i lejeve të ndërtimit	-11.333	7.340	-1.544	0.1253	
Pagesa e taksave	11.319	10.494	1.079	0.2830	
Zgjidhja e paaftësisë paguese	-28.102	12.525	-2.244	0.0267	**
Zbatimi i kontratave	-69.669	11.588	-6.012	<0.0001	***

Mean dependent var	10,725.260	S.D. dependent var	6,433.946
Sum squared resid	249,000,000	S.E. of regression	1,459.151
LSDV R-squared	0.958	Within R-squared	0.956
LSDV F(25, 117)	105.754	P-value(F)	0.000
Log-likelihood	-1,230.402	Akaike criterion	2,512.805
Schwarz criterion	2,589.839	Hannan-Quinn	2,544.108
rho	-0.013	Durbin-Watson	1.855

Joint test on named regressors - Test statistic:  $F(13, 117) = 196.57$ ; with p-value =  $P(F(13, 117) > 196.57) = 6.28694e-73$

Test for differing group intercepts - Null hypothesis: The groups have a common intercept

Test statistic:  $F(12, 117) = 5.34812$ ; with p-value =  $P(F(12, 117) > 5.34812) = 3.71741e-07$



Tabela 5: Tabela përmbledhëse e rezultateve të regresionit linear (Kalkulim i autorëve)

Në tabelën 5 janë paraqitur rezultatet e përmbledhura të analizës së regresionit, e cila u krye për të përcaktuar lidhjen midis variablës së varur të PBB për kokë banori dhe variablave të pavarura (SPMT, SL, EQ, ZLL, KR, KK, FB, RP, ME, TLN, PT, ZPP dhe ZK). Kjo u bë duke përdorur 143 vrojtime në total, me përfshirjen e 13 njësive (shtete) me një gjatësi të serive kohore prej 11 njësi (vitesh).

Bazuar në tabelën e mësipërme të rezultateve të regresionit, rezultati  $R^2$  tregon se variablat e pavarura mund të shpjegojnë 95.76% e variacionit të PBB për kokë banori, ndërsa vlera e R, apo ndryshe edhe si koeficienti i korrelacionit, qëndron në nivelin 0.9786, duke treguar se marrëdhënia midis variablës së varur, dhe variablave të pavarura është një marrëdhënie positive dhe e fortë prej 97.86%, duke treguar se variabiliteti mund të shpjegohet nga regresioni i përdorur në këtë hulumtim. Lidhur me analizën e ANOVA-s, rezultatet tregojnë se variablat e pavarura (SPMT, SL, EQ, ZLL, KR, KK, FB, RP, ME, TLN, PT, ZPP dhe ZK) kanë një ndikim të rëndësishëm në Produktin Bruto të Brendshëm për kokë banori, me një vlerë të  $F(12, 117) = 5.348$ , dhe andaj, bazuar në nivelin e vlerës  $p = 0.000 < 0.01$ , mund të themi se modeli është i përshtatshëm për zhvillimin e marrëdhënies së përmendur në mes të variablave.

## Diskutimet

Rezultatet tregojnë se nga trembëdhjetë variabla të pavarura, dhjetë kanë një ndikim signifikant në PBB, ku nga këto, gjashtë kanë ndikim signifikant pozitiv, dhe katër kanë rezultuar me ndikim signifikant negativ. Duke iu referuar rezultateve të regresionit, mund të shihet se në një nivel të signifikancës prej 99%, variablat si Sundimi i ligjit ( $p < 0.0001$ ), Efektiviteti i qeverisjes ( $p < 0.0001$ ), Zëri dhe llogaridhënja ( $p = 0.0012 < 0.01$ ) si dhe indikator i Marrjes së elektricitetit ( $p < 0.0001$ ) kanë treguar impact pozitiv signifikant reflektuar nga koeficientët pozitiv, dhe vlerat  $p$  më të ulta se 0.01. Mësuhtetur në këto statistika, rezultatet validojnë konkluzionin që me rritjen e koeficientit të Sundimit të ligjit për një njësi (1/100), PBB për kokë banori në vendet e regjionit do të rritet për 241.13 dollarë<sup>10</sup>, me rritjen e koeficientit të Efektivitetit të qeverisjes për një njësi, PBB për kokë banori në vendet e regjionit do të rritet për 129.29 dollarë, ndërsa me rritjen e koeficientit të Zërit dhe llogaridhënjes për një njësi, PBB për kokë banori do të rritet për 102.44 dollarë, si dhe me rritjen e me rritjen e indikatorit të Marrjes së elektricitetit për një njësi, PBB për kokë banori do të rritet për vetëm 39.10 dollarë. Në të njëjtin nivel të signifikancës prej 99%, tre nga variablat e pavarura kanë treguar impact negativ signifikant në PBB për kokë banori. Indikator i stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës/terrorizmit me nivel të signifikancës ( $p = 0.0009 < 0.01$ ) dhe me koeficient prej -49.56, tregon që me rritjen e këtij koeficienti prej një njësi, PBB për kokë banori do të zvogëlohet për 49.56 dollarë, ndjekur nga dy variablat tjera, Fillimi i një biznesi ( $p = 0.0057 < 0.001$ ) dhe Zbatimi i kontratave ( $p < 0.0001$ ), ku me rritjen e koeficientëve në fjalë për një njësi, PBB për kokë banori do të zvogëlohet për 51.25 dollarë,

<sup>10</sup> Kalkulimi i Produktit Bruto të Brendshëm në databazën e Bankës Botërore bëhet në dollarë në bazë të çmimeve aktuale (\$, aktuale)

dhe respektivisht për 69.67 dollarë. Ndërsa, në nivel të signifkancës prej 95%, indiaktori i Regjistrimit të pronës tregoi një impakt signifkant pozitiv ( $p=0.0188<0.05$ ) në PBB për kokë banori, me një koeficient prej 32.41, ndërsa në anën tjetër, Zgjdhja e paaftësisë paguese ( $p=0.0267<0.05$ ) në nivel të signifkancës prej 95% rezultoi me impakt negativ në variablën e varur me një koeficient prej -69.67. Si dhe në fund, variabla e vetme me signifkancë në nivel të 90%, Kualiteti i rregullatorit ( $p=0.0509<0.1$ ) tregon një impakt pozitiv, ku me rritjen e këtij koeficienti prej një njësi, PBB për kokë banori do të rritet prej 56.81 dollarë.

Ndërsa, tre variablat tjera të pavaruara, si Kontrolli i korrupsionit, Trajtimi i lejeve të ndërtimit, si dhe Pagesa e taksave, në bazë të të dhënave statistikore, nuk kanë treguar impakt signifkant në variablën e pavarur, duke u mbështetur në nivelin e vlerës  $p$ , e cila për këto variabla ka rezultuar në vlerat, 0.1253, 0.2830, dhe 0.3169, ku këto vlera janë më të larta se 0.1, andaj edhe nuk paraqesin impakt signifkant në Produktin Bruto të Brendshëm për kokë banori.

## **Konkluzionet**

Bazuar në rezultatet e hulumtimit tonë, duke filluar që nga analizat krahasuese të shteteve që janë pjesë e studimit, e deri tek analiza e regresionit, si dhe po ashtu, duke u mbështetur në pytet hulumtuese të ngritura më lartë, mund të konkludojmë se duke u mbështetur në të dhënat e fundit të mundshme të publikuara në databazën e Bankës Botërore, për indikatorët e të bërit biznes dhe të qeverisjes, shumica e vendeve që janë pjesë e këtij studimi kanë qenë të renditura në anën e shteteve me rezultat të keq, aty ku bëjnë pjesë edhe shtete si Rusia, Bjellorusia, Ukraina, etj., kështu duke dëshmuar se ky vlerësim i dobët për vendet e rajonit paraqet edhe një sfidë në vete duke marrë parasysh së në literaturë, në shumicën e hulumtimeve shkencore, autorët shohin një impakt signifkant të këtyre indikatorëve në tërheqjen e investimeve, dhe në mënyrë indirekte duke kontribuar në rritjen ekonomike.

Shikuar në kontekstin e dy pyetjeve hulumtuese të ngritura për imapktin e dy grupeve të indikatorëve në Produktin e Brendshëm Bruto për kokë banori, në bazë të analizave statistikore, mund të konkludojmë se nga trembëdhjetë variablat e pavarura që kanë qenë pjesë e këtij studimi, dhjetë kanë treguar impakt signifkant në PBB për kokë banori, nga të cilat Sundimi i Ligjit, Efektiviteti i Qeverisjes, Zëri dhe llogaridhënja, Kualiteti i Rregullatorit, Regjistrimi i pronës, si dhe Marrja e elektricitetit kanë treguar impakt signifkant pozitiv në variablën e varur, ku me rritjen e këtyre indikatorëve, do të rritet edhe PBB për kokë banori, kurse Stabiliteti Politik dhe Mungesa

e Dhunës/Terrorizmit, Fillimi i një biznesi, Zgjdhja e paaftësisë paguese, si dhe Zbatimi i kontratave kanë treguar impakt signifkant negativ, ku rritja e këtyre indikatorëve, do të ndikojë në rënien e PBB për kokë banori. Ndërsa, në anën tjetër, tre indikatorët tjerë që përfshijnë Kontrollin e Korrupsionit, Trajtimin e lejeve të ndërtimit, si dhe Pagesën e taksave, në bazë të rezultateve statistikore nuk kanë ndikim signifkant në PBB për kokë banori.

Megjithatë, ky studim ka disa limitime, pasi që të dhënat për indikatorët e të bërit biznes nuk janë të publikuara edhe për vitet e fundit, por janë të kufizuara vetëm deri në

vitin 2020, kështu duke mos përfshirë edhe vitet ku mund të reflektohen edhe ndikimet nga ngjarjet që kanë trazuar botën Europiane më specifikisht.

## Referencat

- Absadykov, Aikozha. 2020. «Does Good Governance Matter? Kazakhstan's Economic Growth and Worldwide Governance Indicators.» *Otoritas Jurnal Ilmu Pemerintahan* 10 (1): 1-13. doi:10.26618/ojip.v10i1.2776.
- Adepoju, Uthman K. 2017. «Ease of Doing Business and Economic Growth.» *Major paper presented to the Department of Economics of the University of Ottawa in partial fulfillment of the requirements for M.A. Degree.* 1-41.
- Aleknaek, Martua, Sayuti, Mulyana, dhe Irka Tia Ginting. 2023. «The Effect of Ease of Doing Business Indicators on Investment Interest: Empirical Evidence in DKI Jakarta Province.» *Jurnal Inovasi Aparatur* 5 (2): 108-121. doi:10.54849/monas.v5i2.172.
- Al-Naser, Maryam, dhe Allam Hamdan. 2021. «THE IMPACT OF PUBLIC GOVERNANCE ON ECONOMIC GROWTH: EVIDENCE FROM GULF COOPERATION COUNCIL COUNTRIES.» *INTERDISCIPLINARY APPROACH TO ECONOMICS AND SOCIOLOGY* 14 (2): 85-110. doi:10.14254/2071-789X.2021/14-2/5.
- Ani, Teodorica G. 2015. «Effect of Ease of Doing Business to Economic Growth among Selected Countries in Asia.» *Asia Pacific Journal of Multidisciplinary Research* 3 (5): 139-145.
- Avdulaj, Jonida, Flora Merko, dhe Klodian Muço. 2021. «The Role of Good Governance in Economic Development: Evidence from Eastern European Transition Countries.» *Journal Transition Studies Review* (28) 1: 67-76. doi:doi.org/10.14665/1614-4007-28-1-006.
- Bouchoucha, Najeh. 2022. «Governance and foreign direct investment: is the low and middle income Africa region different?» *Transnational Corporations Review* 1-13. doi:10.1080/19186444.2022.2028542.
- Febrina, Belinda, dhe Karuniana Dianta Arfiando Sebayang. 2021. «Are Business Regulations Improving Economic Growth? Case Study between ASEAN and European Union.» *Jurnal Pendidikan Ekonomi Dan Bisnis* 9 (1): 44-53. doi:10.21009/JPEB.009.1.5.
- Femina, Mary K S, Anand Patil, Maria John Joseph, dhe Jenova Mary T. 2022. «IMPACT OF EASE OF DOING BUSINESS ON FDI INFLOWS ACROSS DIFFERENT ECONOMIES.» *YMER* 21 (05): 194-216. doi:10.37896/YMER21.05/24.
- Gani, Azmat. 2007. «Governance and foreign direct investment links: Evidence from panel data estimations.» *Applied Economics Letters* 14 (10): 753-756. doi:10.1080/13504850600592598.

- Group, World Bank. 2020. «Doing Business 2020.» Washington, DC: World Bank, 3-19. doi:10.1596/978-1-4648-1440-2.
- Gupta, Surbhi, Surendra S. Yadav, dhe P.K. Jain. 2023. «Does institutional quality matter for foreign direct investment flows? Empirical evidence from BRICS economies.» *International Journal of Emerging Markets*. doi:10.1108/IJOEM-11-2021-1713.
- Haliti, Bersan, Safet Merovci, Alban Hetemi, dhe Sanjib Sherpa. 2019. «The Impact of the Ease Doing Business Indicators on Foreign Direct Investment in the European Transition Economies.» *Ekonomika* 98 (2): 19-32. doi:doi.org/10.15388/Ekon.2019.2.2.
- Hayes, R., Dassen, R., Schilder, A., Wallage, P. 2005. *Principles of auditing An Introduction to International, Standards on Auditing*. Edinburgh Gate Harlow Essex CM20 2JE England: Second Edition, Pearson Education Limited.
- Hossain, Mohamed Tareq, Zubair Hassan, Sumaiya Shafiq, dhe Abdul Basit. 2018. «Ease of Doing Business and Its Impact on Inward FDI.» *Indonesian Journal of Management and Business Economics* 1 (1): 52-65. doi:10.32455/ijmbe.v1i1.52.
- Instituti i Auditorëve të Brendshëm. 2016. *Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)*. © 2016 Instituti i Auditorëve të Brendshëm.
- INTOSAI, KLSH. 2016. *Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI*. Tiranë: INTOSAI e KLSH, Shtypur në Shtypshkronjën: ILAR.
- KAF, Instituti. 2021. *P1-Mjedisi për Auditimin e Brendshëm, Instituti KAF*. Prishtinë: IKAF 2021.
- . 2021. *P3-Praktika në Auditimin e Brendshëm, Instituti KAF*. Prishtinë: IKAF 2021.
- Kaufmann, Daniel, dhe Aart Kraay. 2007. «Governance Indicators: Where are We, Where Should We Be Going?» *The World Bank Research Observer*. doi:10.1093/wbro/lkm012.
- Khan, Itbar, Hayat Khan, dhe Robeena Bibi. 2023. «Institutional Quality and Foreign Direct Investment: Global Evidence.» *Journal of the Knowledge Economy*. doi:10.1007/s13132-023-01508-1.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. *Ligji nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 27 / 03 Qershor 2008.
- . 2011. *Ligji Nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 14 / 9 Shtator 2011, Prishtinë.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2018. *Ligji Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike*. Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 3 / 19 Prill 2018, Prishtinë.
- Marino, P.B.L.P., Romulo Soares, Marcia Martins Mendes De Luca, dhe Alessandra Carvalho de Vasconcelos. 2016. «Global Governance Indicators: how they relate to

the socioeconomic indicators of the Brics countries.» *Revista de Administração Pública* 50 (5): 721-743. doi:10.1590/0034-7612144359.

- MASHTI, Ministria e Arsimit. a.d. *Web faqja e Ministrisë së Arsimit*. <https://masht.rks-gov.net/organogrami/> dhe <https://masht.rks-gov.net>.
- Ministria e Arsimit - MASHTI. 2014. *Udhëzimi administrativ 17/2014 Aplikimi i pagesave të studentëve në Universitetet Publike në Kosovë*. Prishtinë: Ministria e Arsimit - MASHTI.
- Ministria e Financave dhe Transfereve, NjQH për auditimin e brendshëm. 2020. *Doracaku i Auditimit të brendshëm I&II*. Prishtinë: Ministria e Financave dhe Transfereve, NjQH për auditimin e brendshëm.
- Mouller, Robert R. 2009. *Brink's Modern Internal Auditing*. New Jersey: John Wiley & Sons, Inc., Hoboken, New Jersey, Seventh Edition.
- Nawawi, Choirul Hadi, Al Ridhillah Sari, Achmad Vikry Hanif, dhe Fefi Diniyati Sholihah. 2021. «The Effect of Human Development Index, Ease of Doing Business, Corruption, and Distribution of ZIS Funds on Indonesia's Economic Growth.» *Indonesian Economic Review* 2 (2): 70-80. doi:10.53787/iconv.v2i2.11.
- Niarachma, Ranynda, Nury Effendi, dhe Eva Ervani. 2021. «The Effect of Governance on FDI Inflows in ASEAN.» *Optimum Jurnal Ekonomi dan Pembangunan* (11) 1. doi:10.12928/optimum.v11i1.3620. .
- Nikzad, Rashid, dhe Bojan Obrenovic. 2021. «Governance, Institutions, and Economic Development.» *International Journal of Innovation and Economic Development* 7 (4). doi:10.18775/ijied.1849-7551-7020.2015.74.2001.
- Opuala-Charles, Silva, dhe Ijeoma Oshilike. 2023. «Impact of Ease of Doing Business on Foreign Direct Investment in Nigeria Open Access.» *Journal of Economics & Management Research* 1-9. doi:10.47363/JESMR/2023(4)174.
- Pickett, K.H. Spencer. 2010. *The internal auditing handbook*. The Atrium, Southern Gate, Chichester, West Sussex, PO19 8SQ, United Kingdom: Third Edition, A John Wiley and Sons, Ltd., Publication.
- Ponce, L. Arturo Bernal, Ricardo Perez Navarro, dhe Mauricio Ramirez Grajeda. 2019. «Causality between Chinese investment in Latin America and the governance indicators.» *Competition and Regulation in Network Industries* 21 (1). doi:10.1177/1783591719874774.
- Poniatowicz, Marzanna, Ryta Dziemianowicz, dhe Aneta Kargol-Wasiluk. 2020. «Good Governance and Institutional Quality of Public Sector: Theoretical and Empirical Implications.» *EUROPEAN RESEARCH STUDIES JOURNAL* 23 (2): 526-556. doi:10.35808/ersj/1608.
- The Institute of Internal Auditors. a.d. *The Definition of Internal Auditing* [www.theiia.org](http://www.theiia.org). <https://www.theiia.org/en/standards/what-are-the-standards/definition-of-internal-audit/>.



- Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë. 2022. *Raporti i punës i UIBM për vitin 2021*. Mitrovicë: <https://www.umib.net/wp-content/uploads/2022/03/Raporti-vjetor-2021-i-KD-per-MASHTI.pdf>.
- Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë. 2022. *Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2021 në UIBM*. Mitrovicë: <https://www.umib.net/buxheti/>.
- . 2020. *Statuti i UIBM*. Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, <https://www.umib.net/wp-content/uploads/2020/12/Statuti-UIBM.pdf>.
- . a.d. *Web faqja e UIBM*. <https://www.umib.net/wp-content/uploads/2020/05/organogrami-umib-2020-Shqipe-2.jpg>.
- Universiteti i Prishtinës. 2017. *Rregullorja 2/486 për të ardhura personale për personelin akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"*. Prishtinë: <https://dokumente.uni-pr.edu/>.
- Universiteti i Prishtinës, Zyra e auditimit të brendshëm. a.d. [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu). [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu).
- Vokshi, Nexhmie Berisha. 2015. *Kontrolli i Brendshëm dhe Auditimi*. Prishtinë: Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani".
- Zyra Kombëtare e Auditimit. 2019-2022. *ZKA, Raportet e Auditimit për Pasqyrat Financiare të MASHT-it*. Prishtinë: Zyra Kombëtare e Auditimit.
- Zyra Kombëtare e Auditimit. 2019-2020. *ZKA, Raportet e Auditimit për Pasqyrat Financiare të Universitetit të Prishtinës*. Prishtinë: ZKA, (2019-2020) Raportet e Auditimit për Pasqyrat Financiare të Universitetit të Prishtinës.
- Zyra Kombëtare e Auditimit. 2023. *ZKA, Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të MASHTI-it për vitin 2022*. Prishtinë: Marrë nga raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të MASHTI-it për vitin 2022, shih [https://zka-rks.org/cms/uploads/2023/06/RaportiAuditimit\\_MASHTI\\_2022\\_Shqip.pdf](https://zka-rks.org/cms/uploads/2023/06/RaportiAuditimit_MASHTI_2022_Shqip.pdf).
- Zyra Kombëtare e Auditimit. 2020. *ZKA, Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të MASHT-it për vitin 2019*. Prishtinë: Marrë nga raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të MASHTI-it për vitin 2019, shih <https://zka-rks.org/cms/uploads/2020/07/Raporti-i-auditimit-MASHT-2019-Shqip.pdf>.
- Zyra Kombëtare e Auditimit. 2020. *ZKA, Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të UP-së për vitin 2019*. Prishtinë: Marrë nga raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të UP-së për vitin 2019 <https://zka-rks.org/cms/uploads/2020/08/Raporti-auditimit-UP-2019-Shqip.pdf>.
- Zyra Kombëtare e Auditimit. 2021. *ZKA, Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të UP-së për vitin 2020*. Prishtinë: Marrë nga raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të UP-së për vitin 2020 [https://zka-rks.org/cms/uploads/2021/07/RaportiAuditimit\\_UP\\_2020\\_Shqip.pdf](https://zka-rks.org/cms/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_UP_2020_Shqip.pdf).



**Katalogimi në botim – (CIP)**

**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

34:305(062)

Book of Proceedings : security, Peace, and Sustainable Development in a Troubled World : international Conference / the organizing committee Hasan Saliu ... [etj.]. - Prishtinë : AAB, 2024. - 94 f. : ilustr. ; 25 cm.

1. Saliu, Hasan 2. Lecaj, Mentor 3. Buja, Vrullim 4. Hashani, Medain  
5. Brestovci, Albulena 5. Kukaj, Qëndresa

**ISBN 978-9951-832-29-8**

ISBN 978-9951-832-29-8



9 789951 832298